



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/45

Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 20,000,00 (njëzetmijë euro) për mbështetjen e familjeve të zyrtarëve policorë që kanë humbur jetën tragjikisht në magjistralen Kaçanik - Hani i Elezit. Mjetet ndahen nga 10,000,00 (dhjetëmijë) euro për secilën familje.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme me kod 214, në nën programin Shërbimet Administrative me kod 30000, kategoria e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/45  
Datë: 08.05.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për rivarrimin e dëshmorëve të UÇK-së të Zonës Operative të Drenicës në varrezat e dëshmorëve në Kompleksin Memorial në Marinë**

1. Obligohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës që të bëjë përkrahjen për rivarrimin e dëshmorëve të UÇK-së të Zonës Operative të Drenicës nga lokacionet ku janë të varrosur aktualisht.
2. Obligohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës që të bëjë koordinimin e nevojshëm për lokacionin, modalitetet e varrimit, projektin dhe çështjet tjera me:
  - 2.1. Komunën e Skenderajt;
  - 2.2. Komunën e Drenasit;
  - 2.3. Zyrën e Kryeministrit;
    - 2.3.1. Zyrën për Çështje të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së;
    - 2.3.2. Komisionin Qeveritar për Persona të Zhdukur;
  - 2.4. Institutin e Mjekësisë Ligjore;
  - 2.5. Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale.
3. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës do të ofrojë përkrahje logjistike, koordinuese dhe me kapacitetet e saja gjatë tërë procesit.
4. Shpenzimet e rivarrimit do të mbulohen nga buxheti i ndarë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit për shpenzimet e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/45  
Datë: 08.05.2018


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Komisioni për hartimin e Projektligjit për Qeverinë (tutje: Komisioni) në këtë përbërje:

1.1. Z. Besnik Tahiri,	Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore	kryesues;
1.2. Z. Mentor Borovci,	Drejtor i Zyrës Ligjore – ZKM	zv.kryesues;
1.3. Z. Arben Krasniqi,	Drejtor i Sekretariatit Koordinues të Qeverisë	anëtar;
1.4. Z. Selim Selimi,	Këshilltar i Jashtëm Ligjor i Kryeministrit	anëtar;
1.5. Z. Agron Gashi,	Koordinator i Zyrës Ligjore - ZKM	anëtar;
1.6. Znj. Flurije Morina,	Zyrtare e lartë ligjore – ZKM	anëtare;
1.7. Z. Nehat Pllana,	Zyrtar i lartë ligjor - ZKM	anëtar;
1.8. Znj. Kefsere Baliu,	Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet – ZKM	anëtare;
1.9. Z. Dukagjin Abdyli,	Drejtor i Departamenti për të Drejtën e BE - MIE	anëtar;
1.10. Z. Ardian Bajraktari,	Drejtor i Departamentit Ligjor - MD	anëtar;
1.11. Z. Enis Spahiu,	Drejtor i Departamentit Ligjor – MF	anëtar;
1.12. Z. Naser Shamolli,	Drejtor i Departamentit Ligjor – MAP	anëtar;
1.13. Z. Shkëlqim Jakupi,	Drejtor i Departamentit Ligjor – MAPL	anëtar;
1.14. Z. Jetish Jashari,	Drejtor i Departamentit Ligjor – MPJ	anëtar;
2. Me pajtimin e Kryesuesit të Komisionit mund të ftohen edhe përfaqësues të institucioneve të tjera publike, Organizatave Ndërkombëtare dhe Organizata të Shoqërisë Civile si dhe persona tjerë.
3. Me qëllim të kryerjes efikase të aktivitetit të tij, Komisioni mund të formojë grupe punuese të përkohshme si dhe mund të angazhojë ekspertë nga fusha e të drejtës kushtetuese.
4. Komisioni është i obliguar që për punën e tij t'i raportojë Qeverisë kurdo që kërkohet raport për ecurinë e punës së Komisionit.

5. Zyra e Kryeministrit obligohet për sigurimin e kushteve materiale, teknike dhe kushteve tjera për punën e këtij Komisioni.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/45  
Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me Përfundimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës nr. 06-P-028 të datës 27 shkurt 2018, jep mendim lidhur me Projektligjin për Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz.
2. Ky vendim, bashkë me mendimin dhe materialin përcjellës lidhur me Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi, i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/45

Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Rregullores (QRK) - Nr. 21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Pika 1.3. dhe Pika 1.4. e Vendimit të Qeverisë Nr. 08/73 (05.02.2016) fshihen dhe riformulohen me tekstin si në vijim:
  - 1.3. Ivan Milojevic, ZKM, anëtar;
  - 1.4. Mimoza Jakupaj, MASHT, anëtare.
2. Masat e përcaktuara në Rregulloren (QRK) - Nr.21/2015 për procedurat dhe kriteret për lëshimin e certifikatave shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike, vlejné edhe për një vit shtesë, pas kalimit të mandatit sipas Rregullores (QRK) - Nr. 21/2015.
3. Obligohet Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, të vazhdojë punën edhe për një vit shtesë.
4. Obligohet Zyra Ligjore, në Zyrën e Zyra e Kryeministrit, që në bashkëpunim me Komisionin për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, që brenda më së largu tre muajsh të paraqesë për miratim në Qeveri ndryshim plotësimet e nevojshme të Rregullores (QRK) - Nr.21/2015.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/45

Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Themelohet Grupi Punues për themelimin e Zonës së veçantë Ekonomike Amerikane në këtë përbërje:

1.1. Z. Erolld Belegu	Këshilltar i Kryeministrit	kryesues;
1.2. Z. Durim Limaj	Shef i Kabinetit të Ministrit - MTI	zv. kryesues;
1.3. Përfaqësues	Drejtor i Përgjithshëm - KIESA MTI	anëtar;
1.4. Përfaqësues	Zyra Ligjore - ZKM	anëtar;
1.5. Përfaqësues	Departamenti Ligjor - MTI	anëtar;
1.6. Përfaqësues	Departamenti Ligjor - MPJ	anëtar;
1.7. Përfaqësues	Departamenti Ligjor - MPB	anëtar;
1.8. Përfaqësues	Departamenti Ligjor - MAPL	anëtar;
1.9. Përfaqësues	Agjencia Kosovare e Privatizimit	anëtar;
1.10. Përfaqësues	Agjencia Kadastrale e Kosovës	anëtar;
1.11. Përfaqësues	Departamenti i Shpronësimit - MMPH	anëtar;
1.12. Përfaqësues	Departamenti i Politikave Ekonomike, Publike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar Financiar	anëtar;
1.13. Përfaqësues	Administrata Tatimore e Kosovës	anëtar;
1.14. Përfaqësues	Dogana e Kosovës	anëtar;
1.15. Përfaqësues	Ministria e Integritimit Evropian	anëtar;

2. Grupi punues ka për detyrë të identifikojë legjislacionin, lokacionin, procedurat dhe të gjitha çështjet tjera relevante që mundësojnë themelimin e Zonës së Veçantë Ekonomike Amerikane. Si rezultat, Grupi punues do të përgatisë tërë dokumentacionin relevant që i mundëson Qeverisë së Republikës së Kosovës themelimin e Zonës së Veçantë Ekonomike Amerikane.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 07/45  
Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndarjen e mjeteve në shumë prej 57,944.38 (pesëdhjeteshtatë mijë e nëntëqindëdyzetkatër euro e tridhjetetë centë) për pagesën e punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta në rezidencën presidenciale "Ibrahim Rugova".
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi, ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara, me kod 13100, kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nën programi Administrata Qendrore me kod 11307, në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 08/45

Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti i katërt mbi Planifikimin dhe Implementimin e 'Klauzolës për Investime'.
2. Raporti nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për informim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 09/45  
Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e “Marrëveshjes për Shmangien e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital” me Shtetin e Katarit.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 10/45

Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë për financimin e projektit të Sistemit të Furnizimit me Ujë për Komunën e Graçanicës.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 11/45

Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Kredisë në mes të Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG, për financimin e projektit të sistemit të furnizimit me ujë në Komunën e Istogut.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 12/45  
Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Drejtësisë për negocimin e Marrëveshjes për Ndihmë Juridike në Çështje Civile me Republikën e Maqedonisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Drejtësisë obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Ramush HARADINAJ**



Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 13/45  
Datë: 08.05.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017 dhe me Rregulloren nr. 16/2017, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, duke shqyrtuar kërkesën e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, me nr. prot. 840, datë 4 maj 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 8 maj 2018, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për shkarkimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike NH "Iber Lepenc" Sh.A**

1. Shkarkohen nga pozita e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, si në vijim:
  - 1.1. Fatos Sahiti;
  - 1.2. Albiona Maloku;
  - 1.3. Imer Hamiti;
  - 1.4. Sami Veliu.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Njësia për Politika dhe Monitorimin e NP-ve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**A r s y e t i m**

Në mbledhjen e datës 10 prill 2018, Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Hidroekonomike "Iber Lepenc" Sh.A. ka nxjerrë vendim, me shumicë votash, për ndarje të shpërblimit në lartësinë 50 % të honorarit themelor vjetor për anëtarët e Bordit të Drejtorëve për vitin 2017 si dhe një pagë shtesë mujore (paga e 13-të) për të gjithë të punësuarit e Ndërmarrjes Hidroekonomike "Iber Lepenc" Sh.A.

Duke pasur në konsideratë që Ndërmarrja Hidroekonomike "Iber Lepenc" Sh.A. për vitin 2017 ka shënuar humbje neto në vlerë 4,177,032 euro, sipas Raportit të Auditorit të Pavarur, vendimi i tillë cenon skajshmërisht likuiditetin e ndërmarrjes duke krijuar situatë të pafavorshme financiare për ndërmarrjen dhe aksionarin.

Vendimi nr. 01/768, i datës 10.04.2018, i nxjerrë me shumicë votash nga Bordi i Drejtorëve të Ndërmarrjes Hidroekonomike "Iber Lepenc" Sh.A. është në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, si dhe me nenin 20 paragrafi 20.5 të Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Prandaj, duke marr në konsideratë shkeljet e kryera me rastin e marrjes së këtij vendimi, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Ramush HARADINAJ**  
  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeveris